

KONTRATË SHITJE AKSIONESH
ME KUSHT

Sot më datë 11 / 02/2019, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë :

SHITËSI : Z. Fadil ALLAJBEU, shtetas shqiptar, i biri i Mehdiut, lindur më datë 21.02.1952, identifikuar me letërnjoftimin me nr. 024433171 dhe nr. Personal F20221072P, madhor, me zotësi të plotë e për të vepruar *[në cilësinë e Shitësit]*

Dhe

BLERËSI : Z. Artur AGOLLI, shtetas shqiptar, i biri i Ylberit, lindur më datë 17.08.1961, banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal G108170221, madhor, me zotësi të plotë e për të vepruar *[në cilësinë e Blerësit]*.


OBJEKTI : Shitja e 664,396 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që përfaqësojnë 0.855% të kapitalit të saj, që zotërohen nga aksionari **Z. Fadil ALLAJBEU** dhe blerja e tyre nga **Z. Artur AGOLLI**.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a, është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K316088010 si dhe me licencën Nr.16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Shitësi, Z. Fadil ALLAJBEU zotëron 664,396 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë), aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a ("*aksionet*"), që përfaqësojnë 0,855% të kapitalit të kësaj shoqërie, sic rezulton dhe vërtetohet nga dokumentet e shoqërisë.

Blerësi, z.Artur Agolli është i interesuar që të bleje paketen e mesiperme të aksioneve, sipas kushteve dhe afateve të percaktuara në kete kontrate.



ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS.

664,396 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksionet që shiten, janë vlerësuar nga palët me vlerën totale prej **1.540.000** euro (*nje million e peseqind e dyzet mije euro*) – (*çmimi i shitjes*).

Pagesa e çmimit te shitjes në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins.

Pagesa e mesiperme do te kryhet me menjehere me vertetimin e njerit prej 2 kushteve:

- (a) të vertetohet dhenia e miratimit me shkrim nga aksionari zotërues i aksioneve të zakonshme “të kategorisë ”A”, shoqëria B.F.S.E Holding BV, përfaqësuar nga Z. Clive MOODY, si dhe nga dy anetare të Drejtorise së BANKA CREDINS sh.a. për shitjen e 664,396 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksioneve të “BANKA CREDINS” sh.a (“*aksionet*”), që përfaqësojnë 0.855% të kapitalit të saj, nga Z. Fadil ALLAJBEU tek Z. Artur AGOLLI;
ose,
- (b) vertetohet se paketa e aksioneve që shiten ju eshte ofruar paraprakisht aksionereve të tjere në funksion të së drejtes së tyre të parablerjes dhe aksioneret nuk kane shprehur interes.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Me vertetimin e kryerjes se pageses së plote të çmimit të shitjes, në kushtet dhe afatet e mesiperme, **Shitësi** është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** 664,396 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksione të shoqërisë “BANKA CREDINS” sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Nga ana e tij, **Blerësi, Z. Artur AGOLLI** është plotësisht dakord që të blejë 664,396 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksione të shoqërisë “BANKA CREDINS” sh.a, të zotëruara nga shitësi në kapitalin aksionar të Bankës, sipas kushteve dhe afateve të mesiperme.

Kështu, me përfundimin e këtij transaksioni shitje, Z. Fadil ALLAJBEU nuk do të zotërojë aksione në kapitalin e shoqërisë “BANKA CREDINS” sha, ndërsa Z. Artur AGOLLI do të zotërojë 664,396 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) aksione, që përfaqësojnë në total 0.855% të aksioneve të shoqërisë “BANKA CREDINS” SHA.



LIGJI I ZBATUESHEM

Palët bien dakort që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen dhe Ligji Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.


KLAUZOLA SHITESË TË KONTRATËS

Shpenzimet e regjistrimit të kontratës në QRA (Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve), do të përballohen nga pala blerëse.

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e te pavesuar.

SHITËSI

Z. Fadil ALLAJBEU



BLERËSI

Z. Artur AGOLLI

